



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 januar 2012
Nr. ref.: 190/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 90,91,92,93,94 dhe 95/10,
të bashkuara me vendimin UR 90-10-bk/10, të datës 8 tetor 2010

Parashtrues

Të gjithë aksionarët e Holding "Jatex-Conitex" sh.a, Holding "Jatex-Modatex" sh.a, Holding "Jatex-Jatex Commerce" sh.a, Holding Corporacy "Jatex" sh.a, Holding "Jatex-Junitex" sh.a dhe Holding "Jatex-Tricotex" sh.a

Të përfaqësuar nga avokatët: z. Gazmend Nushi dhe z. Ahmet Hasolli

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë aksionarët e Ndërmarrjes Holding Corporacy "Jatex" me njësitë Holding "Jatex-Conitex" sh.a; Holding "Jatex-Modatex" sh.a; Holding "Jatex-jatex Commerce" sh.a; Holding "Jatex-Junitex" sh.a; Holding "Jatex-Tricotex" sh.a, me seli në Gjakovë dhe Junik, të cilët me autorizim i përfaqësojnë avokatët z. Gazmend Zhushi dhe z. Ahmet Hasolli.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të kontestuara në Gjykatën Kushtetuese janë:

Vendimi i AKP-së për aprovimin e rekomandimeve për trajtimin e ndërmarrjeve "Emin Duraku", "Jatex" dhe "Deva" si ndërmarrje shoqërore, i datës 29 prill 2010; dhe

Vendimi i AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k.

Objekti i çështjes

3. Vendimi i AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, të cilat sipas përfaqësuesve të aksionarëve të kësaj ndërmarrje janë bërë pa pasur bazë ligjore dhe se me këtë veprim AKP-ja ka bërë shkelje të nenit 46.1 dhe 46.3 të Kushtetutës së Kosovës (e drejta e pronës) të ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 shtator 2010, përfaqësuesit ligjorë të parashtruesve të kërkesës, avokatët: z. Gazmend Nushi dhe z. Ahmet Hasolli, parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke cilësuar si jo ligjore vendimet e AKP-së për aprovimin e rekomandimeve për trajtimin e ndërmarrjeve "Emin Duraku", "Jatex" dhe "Deva" si ndërmarrje shoqërore, të datës 29 prill 2010, dhe vendimin e AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k.
6. Më 9 nëntor 2010, Gjykata Kushtetuese njoftoi palët për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi komentet eventuale lidhur me kërkesën.
7. Më 23 nëntor 2010 dhe me 10 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka marrë përgjigje me shkrim dhe komentet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me kërkesën.
8. Më 12.05.2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të Snezhana Botusharova (kryesuese) dhe Robert Carolan e Altay Suroy, anëtarë, i rekomandoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Sipas parashtruesve të kërkesës, të gjashtë ish OTHPB-të, tani parashtruesit e kërkesës, në vitin 1990, sipas legjislacionit në fuqi të asaj kohe, janë ndarë nga Kombinati Industrial "Emin Duraku" dhe janë transformuar në Shoqëri Aksionare. Ky transformim sipas tyre ishte bërë në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet (Gaz. zyr. e RSFJ nr 77/88,40/89,46/90 dhe 61/90).

10. Më 16 gusht 1991, duke marrë parasysh faktin se shumë faza të prodhimit të tyre ishin të ndërlidhura në mes vete, si dhe faktin se të gjitha kompanitë, përpos 'Junitex', e kishin selinë në të njëjtin kompleks në Gjakovë, këto kompani morën VENDIM për themelimin e HOLDING CORPORACY "JATEX" sh.a.
11. Me këtë vendim kompanitë vendosën që në 'HOLDING CORPORACY' të bartin 51% të aksioneve, ndërsa 49 % të tyre t'i mbajnë për vete.
12. Më 22.11.1991, Holding Corporacy 'Jatex' u regjistrua në Gjykatën e Ekonomike të Qarkut në Gjakovë dhe mori Vendimin nr Fi.2917/91. Gjithashtu në Gjykatën Ekonomike të Qarkut u regjistruan edhe ndërmarrjet që ishin të bashkuara në të, e që tani kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
13. Më 24.12.1992, Holding-u mori Vendimin 06-194/2 për emetimin e aksioneve interne në APOENA dhe secili prej aksionarëve u pajis me këto fletëaksione.
14. Në një formë të tillë të strukturimit Holding Corporacy "Jatex" dhe ndërmarrjet e bashkuara në të kanë funksionuar deri në vitin 1999.
15. Duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë VII.C 29/06, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregtar në Kosovë, ka regjistruar Holding "Jatex" dhe të gjitha Kompanitë tjera që tani kanë paraqitur kërkesë në Gjykatë Kushtetuese duke i cilësuar si **"Ndërmarrje tjera nën juridiksionin e AKM-së"**.
16. Më 22 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit lëshoj një komunikatë për medie në të cilën njofton publikun për vendimin e Bordit të AKP-së që ndërmarrjet "Emin Duraku", "Jatex" dhe "Deva", nga Gjakova, t'i trajtojë si ndërmarrje shoqërore.
17. Më 20 maj 2010, AKP i kishte dërguar njoftim të veçantë me shkrim Ndërmarrjes 'Jatex' lidhur me Vendimin e Bordit të AKP -së për cilësimin e Kompanisë "Emin Duraku", në Gjakovë, pjesë e së cilës para ndarjes ishte e dhe 'Jatex' si 100% ndërmarrje shoqërore duke e venë nën administrim të AKP-së dhe njëkohësisht e njoftoi edhe me bazën ligjore për marrjen e një vendimi të tillë.
18. Më 30 gusht 2010, AKP kishte dërguar njoftimin për refuzimin e ankesës së "Holding Corporacy Jatex", duke e njoftuar se AKP edhe më tej do të vazhdojë ta administrojë Kompaninë "Jatex" si ndërmarrje shoqërore dhe duke e udhëzuar atë se lidhur me këtë vendim, kjo kompani, mund të ankohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
19. Më 07.09.2010, AKP ka shpallur Valën e 45 A të privatizimit dhe në të ishin publikuar për privatizim edhe ndërmarrja e re "Jatex fabrika e re" sh.p.k dhe ndërmarrja e re "Jatex Kompleksi Industrial", pjesë e të cilave, sipas shpjegimit plotësues të AKP-së, janë edhe Holding Corporacy "Jatex", Holding "Jatex-Conitex"sh.a, Holding 'Jatex-Modatex"sh.a, Holding "Jatex-jatex Commerce" sh.a, Holding "Jatex-Junitex"sh.a dhe Holding "Jatex-Tricotex" sh.a.
20. Më 21 tetor 2010, AKP ka nxjerrë Aktvendimin **SCC- 10 -0215**, me të cilën ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka APLIKUAR **masën e përkohshme** duke NDALUAR shitjen e aseteve të shpallura për privatizim të ndërmarrjes së re "Jatex Fabrika e Re" sh.p.k dhe Fabrika e re "Jatex Kompleksi Industrial" sh.p.k, deri në vendimin përfundimtar për zgjedhjen e padisë nga kjo Gjykatë.

21. Nga dokumentacioni i paraqitur në lëndë, si dhe nga përgjigjet e palëve të involvuara në këtë lëndë, konstatohet se ky proces në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme nuk ka përfunduar ende.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre, në cilësinë e aksionarëve të ndërmarrjes, me vendimet e AKP-së u janë cenuar e drejta e pronës e garantuar me Kushtetutën e Republikës Kosovës, më saktësisht, sipas tyre janë shkelur neni 46 pika 1 dhe 3 e Kushtetutës.
23. Ata gjithashtu ankohen se Agjencia Kosovare e Privatizimit duke mos marrë parasysh statusin juridik të ndërmarrjes Holding "Jatex-Corporacy 'sh.a dhe të gjitha njësitë e lartcekura, të përcaktuar me legjislacionin në fuqi të vitit 1991 dhe veprimin e vazhdueshëm të këtyre ndërmarrjeve me këtë status juridik deri në vitin 1999, në mënyrë arbitrare, me vendimin e datës 29 prill 2010, ka përcaktuar një status të ri juridik për këto ndërmarrje duke i cilësuar si 100% shoqërore me të gjitha asetet e tyre dhe padrejtësisht i ka venë në menaxhim të AKP-së. Me këtë vendim, sipas tyre, ata në mënyrë kundërkushtetuese janë privuar nga e drejta e pronësisë të fituar nëpërmes aksioneve që i kanë poseduar në ndërmarrje dhe që, sipas tyre, i kanë realizuar në mënyrë tërësisht ligjore.
24. Parashtruesit e ankesës, gjithashtu, kanë theksuar se ata edhe pse kanë dërguar kërkesë për masë të përkohshme në Gjykatën Supreme-Dhoma e Veçantë, ata nuk e njohin juridiksionin e kësaj Gjykate andaj kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që ajo ta vendos kërkesën në mënyrë meritore.

Komentet e Autoritetit publik

25. Më 23 nëntor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dërguar përgjigjeje me shkrim për lëndën KI 95/10 në të cilën ka theksuar se "parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur kërkesë edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, lënda nr.SCC-10 -0215 dhe se kjo dhomë më 21.10.2010 ka aprovuar masën e përkohshme me Aktvendimin nr SCC- 10-0215, me anë të cilit AKM-së i ndalohej shitja e aseteve të shpallura për privatizim deri në vendosjen përfundimtare të padisë".
26. Duke vepruar sipas kërkesës për sqarim plotësues të Gjykatës Kushtetuese, AKP, më 10 mars 2011, ka dërguar përgjigjeje shtesë në kërkesë në të cilën ka sqaruar se: të gjitha shoqëritë aksionare të cilat kanë parashtruar kërkesa në Gjykatën Kushtetuese janë asete të Ndërmarrjes së re "Jatex Fabrika e re" sh.p.k dhe të Ndërmarrjes së re "Jatex Kompleksi Industrial" sh.p.k, e të cilat janë tenderuar në valën e 45 A të privatizimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë dhe lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës ku thuhet:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës i cili përcakton se:

‘Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme’.

28. Duke shqyrtuar gjithë dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga palët, Gjykata në mënyrë të pakontestueshme konstaton se palët që kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kanë parashtruar gjithashtu edhe padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe se në atë Gjykatë, lidhur me këtë padi, akoma nuk është nxjerrë një vendim përfundimtar dhe se lënda është akoma në procedurë, që rrjedhimisht, nënkupton faktin se palët nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, dhe në këto kushte nuk kanë përmbushur kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.
29. Gjykata nuk mund të pranojë si të arsyeshme kërkesën e parashtruesve për mos njohjen e juridiksionit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme kur me Rregulloren **2002/13 (UNMIK, të datës 13 qershor 2002)**, në nenin 1.1, qartazi përcaktohet: me anë të kësaj themelohet një **Dhomë e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës** për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Veçantë).
30. Gjykata Kushtetuese gjithashtu çmon faktin se është pikërisht “vendimi juridik” i kësaj Dhome të Veçantë të Gjykatës Supreme (Aktvendimi për masë të përkohshme nr. SCC-10-0215) i cili ka pezulluar privatizimin e ndërmarrjeve në të cilat parashtruesit e kërkesës kanë interesa, dhe ky aktvendim është marrë mbi bazën e kërkesës së përfaqësuesve ligjorë të tyre, andaj është e qartë se Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë një vendim deri sa Gjykata Supreme nuk e përfundon këtë proces.
31. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
32. Gjykata, një arsyetim të tillë e kishte aplikuar gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave e në rastet: KI 55/10 Hamide Osaj , në kërkesën për Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, i datës 4 qershor 2010, Rastin nr. KI 20/10 Muhamet Bucaliu kundër Vendimit të Prokurorit të shtetit KMLC.nr. 09/10, të 24 shkurtit 2010 (vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 15 tetor 2010).
33. Në këto rrethana, kërkesa është **e paparanueshme**, sepse palët **nuk i kanë shteruar** të gjitha mjetet juridike para se t’i drejtoheshin Gjykatës **Kushtetuese** dhe parashtruesit nuk i kanë plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36. paragrafi 1(a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 12.05.2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme sepse parashtuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani